



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar rre dt.	11.05.2021
Zyra e pranimit	No. i protokollit
308	01-151

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Naser Bajraktar

Prizren, më 11.05.2021

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 1 dhe 2, nenit 154 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, duke u bazuar në nenin 11 të Rregullores për zgjedhjet Studentore në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 07.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shpallen zgjedhjet për Parlamentin e Studentëve dhe Këshillat e Studentëve në Fakultetet e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren
- II. Zgjedhjet për Parlamentin e Studentëve dhe Këshillat e Studentëve zyrtarisht fillojnë nga data 12.05.2021 dhe përfundojnë sipas dinamikës të përcaktuar nga Këshilli Drejtues, më së largu deri më 17.06.2021.
- III. Zgjedhjet do të mbahen në përputhje me Statutin e Universitetit dhe Rregulloren me nr. prot. 07-2018, të datës 09.02.2018, për Zgjedhjet e Studentëve të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.
- IV. Të gjitha palët të cilat angazhohen në këtë proces zgjedhor duhet të tregojnë korrektësi dhe veprojnë në përputhje me vlerat demokratike.
- V. Ftohen të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile të Republikës së Kosovës, KQZ-së, OSBE-së, misionet diplomatike në Kosovë si dhe të gjithë mediat e shkruara dhe elektronike, që të jenë vëzhguese dhe të monitorojnë zgjedhjet studentore të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prof. Asoc. Dr. Naser Bajraktari


Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Njësive akademike;
- Parlamentit të Studentëve;
- Zyrës ligjore;
- Arkivit.